



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

V E N D I M

Nr. 4, Datë 06.01.2015

Mbi pavlefshmërinë e Vendimeve të KKDM^{se} me nr. 2, datë 04.07.2014 dhe nr.3, datë 23.09.2014 , të marra për miratimin e “Studimit hidroteknik për sigurinë e digës së Liqenit Artificial të Tiranës dhe masat mbrojtëse nga diga”.

KKDM, morri në shqyrtim “Raportin e Kontrollit” të kryer nga Njësia e Kontrollit të Brendshëm dhe Antikorrupsionit të Këshillit të Ministrave.

Ky raport është përcjellë pranë KKDM me shkresën Nr.4372/1, dt.26.12.2014 dhe trajton kontrollin e ushtruar në KKDM për zbatimin e procedurave ligjore e administrative, lidhur me marrjen e Vendimeve Nr.2, dt.04.07.2014 dhe Nr.3, dt. 23.09.2014 për miratimin e “Studimit hidroteknik për sigurinë e digës së Liqenit Artificial të Tiranës dhe masat mbrojtëse nga diga.”

KKDM shqyrtoi me shumë seriozitet dhe përgjegjësi rastin duke u mbështetur në dokumentacionin përkatës dhe konstatoi se :

- Në mbledhjen e datës 19.09.2014, të zhvilluar për marrjen e Vendimit Nr.3, dt. 23.09.2014, për “Miratimin e studimit hidroteknik për sigurinë e digës së Liqenit Artificial të Tiranës”, nuk është vepruar me procedurën e votimit sipas përcaktimit që bëhet në Nenin 7 të VKM nr. 278, datë 08.05.2003 për “Rregulloren e funksionimit të Komitetit Kombëtar të Digave të Mëdha”(KKDM).
- KKDM nuk ka shqyrtuar një material a dokumentacion të titulluar dhe hartuar nga studio e licensuar, që të trajtojë “ Studimin hidroteknik për sigurinë e digës

së Liqenit Artificial të Tiranës” që do ishte pjesa themelore e studimit që ka të bëjë me legjislacionin për sigurinë e digave, por janë shqyrtuar vetëm disa masa mbrojtëse për objektin e propozuar për ndërtim.

- Studimi i paraqitur pranë KKDM nuk ka qenë i paraqitur në minimum dy variante siç kërkohet nga Neni 5 pika A e ligjit nr. 8681, dt.02.11.2000 “Për projektimin, ndërtimin, shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e digave dhe dambave” neni 8 pika 1 dhe neni 9 pika 1.5.4 e VKM nr.147 dt. 18.10.2004 “Rregulloren për sigurinë e digave dhe dambave”

Në këto kushte nisur nga konstatimet e mësipërme, anëtarët e KKDM me votim të plote me pjesëmarrjen e anetareve të KKDM në mbledhjen e datës 06.01.2015 :

V E N D O S I :

1. Konstatimin si absolutisht të pavlefshme të vendimeve Nr.2, dt.04.07.2014 dhe Nr.3, dt.23.09.2014 të KKDM, për miratimin e “Studimit hidroteknik për sigurinë e digës së Liqenit Artificial të Tiranës dhe masat mbrojtëse nga diga”
2. Të njoftohet, menjëherë, Bashkia e Tiranës dhe organet e tjera përkatëse lidhur me këtë vendim.

K R Y E T A R I

Inxh. Maksim MUÇI

